



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226808

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06053168

AC-I-23-0057

Në ankesën e

Paditësi

R K, Prizren, i përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

N.SH "Komuna", Prizren (në Likuidim) e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-7222 të datës 06 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-7222 i datës 06 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Në vitin 2013, pranë DHPGJS përfaqësuesi i paditësit ka parashtruar ankesë kolektive për grupin e punëtoreve kundër të paditurës, në lidhje me Vendimet e Autoritetit të Likuidimit (AL) për NSH "Komuna" me të cilat janë refuzuar kërkesat për kompensimin e pagave të pa paguara. Rasti ishte regjistruar si C-IV.-13-2716, por që DHPGJS me urdhrin, C-IV.-13-2716, datë 28 tetor 2014, kishte urdhëruar përfaqësuesin e paditësit që të paraqes ankesë të veçantë për secilin paditës. Me 27 nëntor 2014, përfaqësuesi i paditësit ka paraqitur ankesë të veçantë për paditësin dhe lënda është regjistruar me shenjen, si C-IV.-14-7222. Më ankesë dhe me parashtresën e dt. 22 gusht 2022, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit ka kundërshtuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) PRZ035-0180/29, të datës 30 shtator 2013, me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor të vitit 2005, në shumën prej 2,356.00 euro, me arsyetim se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar. Paditësi i kundërshton këto konstatime të Autoritetit të Likuidimit duke i konsideruar si jo të drejta. Paditësi pretendon se në rastin e tij nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, dhe rrjedhimisht gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale. Paditësi thekson se ka punuar tek e paditura prej datës 02 shkurt 1961 deri më 27 mars 2007, kur të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e AKM-së dhe se ka pranuar njoftimin i cili e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit, andaj nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës. I ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar dhe t'ia njoh shpenzimet e procedurës. Bashkë me ankesë dhe me parashtresë paditësi ka dorëzuar, Autorizimin për përfaqësim, Vendimin e AL PRZ035-0180/29, të datës 30 shtator 2013, Njoftimin për Ndërprerje të Marrëdhënies së punës të datës 27 mars 2007, po ashtu edhe listën e pagave për vitin 2004 dhe 2005 si dhe Kopjen e Librezës së Punës.

Me 10 mars 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja është deklaruar se NSH "Komuna" ka hyrë në procedurë të likuidimit më 06 mars 2008 ndërsa paditësi ka ushtruar kërkesë kreditore me 12 maj 2008 duke kërkuar kompensimin për paga të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor të vitit 2005, në shumën 2,356.00 euro. AKP-ja ka pohuar se paditësi ka dështuar të theksoj në ankesë se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me

vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se pagat e kërkuara nga paditësi nga muaji janar 2004 e deri në dhjetor 2005 janë të parashkuara, pasi që ai nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi me të cilën do të dëshmonte se i ka kërkuar këto paga para ndonjë Gjykate apo organi tjetër kompetent në afatin prej tri viteve. Andaj me të drejtë Autoriteti i Likuidimit kërkesën e ka refuzuar si të pa vlefshme pasi që ajo ishte parashkuar.

Me 06 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-7206 e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshon Vendimin e Autoritetit të Likuidimit për NSH "Komuna", PRZ035-0180/29, të datës 30 shtator 2013, dhe obligon të paditurën që paditësit për paga të pa paguara për periudhën mars 2004 deri dhjetor 2005, t'ia paguajë shumën 2,076.36 euro, si dhe për shpenzime të procedurës në shumën 125.00 euro, sipas prioritete të përcaktuar me shtojcën e Ligjit nr.04/L034 të AKP-së në procedure të likuidimit. Pjesa tjetër e kërkesës së paditësit mbi shumën e aprovuara ishte refuzuara si e pabazuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se paditësi ishte një punëtor i NSH "Komuna" në Prizren, dhe se kjo është dëshmuar me provën e listës së pagave të pa paguara për Punëtorët e NSH-së "Komuna" për periudhën e vitit 2004 dhe vitit 2005, vërtetohet se paditësi ishte në listën e pagave. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se njoftimi i AKM-së i datës 27 mars 2007 për paditësin me të cilin ka përfunduar punësimi për shkak se shitjes së aseteve të ndërmarrjes, ka prodhuara efekt juridik si për paditësin si për punëtor ashtu edhe për ndërmarrjen, si punëdhënës sa i përket të drejtave dhe obligimeve të krijuara nga marrëdhënia e punës deri më 27 mars 2007. Ky njoftim kishte prodhuar efekt juridik edhe në lidhje me borxhet/pagat e pa paguara deri në ditën e lëshimit të tij, si për paditësin ashtu edhe për të paditurën. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se periudha janar 2004 deri në dhjetor 2005 nuk është parashkuar është arsye se paditësi si provë materiale ka bashkangjitur Letër Pezullimin e cila në kuptim të nenit 387 të LMD-së, nënkupton se parashkrimi është ndërprerë dhe ka filluar të rrjedhë afati i ri i parashkrimit. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësit nuk i është parashkuar kërkesa tij kreditore dhe se të njëjtit ju njihet e drejta për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën Mars 2004-Dhjetor 2005, e cila nuk është parashkuar, sepse paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës më 27 mars 2007, dhe se paditësi konform dispozitave të lartpërmendura ligjore që rregullojnë parashkrimin, ka pasur të drejtën që të kërkojë pagat për tri vitet e fundit. Sa i përket periudhës nga pushimi

i marrëdhënies së punës, datë 27.03.2007, e deri në ditën e dorëzimit të kërkesës kreditore pran AL-së, gjykata konsideron se nuk ka pasur rrjedhje të afatit të parashkrimit, sepse çështja ka qenë në përgjegjësinë e AKP-së që të filloj me procedurën e likuidimit të Ndërmarrjes, ndërsa paditësi ka qenë në pritje të fillimit të asaj procedure, sipas udhëzimeve që ka pranuar me letër pezullimin nga puna. Rrjedhimisht, kërkesëpadia është aprovuar pjesërisht si në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pagat për muajt Janar dhe Shkurt të vitit 2004, shkalla e parë ka vlerësuar se është parashkruar kërkesa, ngase paditësi nuk ka paraqitur apo prezantuar ndonjë ngjarje juridike (veprim ligjor, padi, deklaratë e pohimit të borxhit), që do të shkaktonte ndërprerjen e afatit të parashkrimit në lidhje me këto paga. Paditësi ka parashtruar kërkesën me datën 12 maj 2008, që donë të thotë pas kalimit të afatit prej tri viteve. Duke u bazuar në nenin neni 372.1 të LMD-së, ku është përcaktuar se *afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*, shkalla e I-rë ka ardhur në përfundimin se kërkesa për pagat e muajit Janar dhe Shkurt 2004, është parashkruar.

Shkalla e i-rë ka konstauruar se sikurse legjislacioni që ishte në fuqi para vitit 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se *"pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri vite"*. Me 31 janar 2023, e paditura e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-7222 të datës 06 janar 2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ035-0180/29 i datës 30 shtator 2013.

Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra

përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja ka pretenduar se kërkesa për 3 paga të fundit të papaguara është dashtë të paraqitet brenda tre viteve nga viti 2004, prej kur paditësi nuk ka përfituara të ardhura personale, që nënkupton se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Më 07 shkurt 2024, përfaqësuesi i paditësit e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje paditësi pohon se AKP-ja vetëm i ka përsëritë pretendimet e veta të mëhershme dhe nuk ka paraqit ndonjë fakt apo provë që do ta kundërshtonte gjendjen e vërtetuar drejtë faktike nga Shkalla e I-rë. Tutje paditësi pretendon se janë të gabuara pretendimet e AKP-së për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike apo aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Po ashtu ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës për vlerësimin e situatës faktike në mënyrë të gabuar, pasi që gjykata e shkallës së parë ka administruar dhe ka nxjerrë të gjitha provat e propozuara të cilat i ka konsideruar si të nevojshme për të vërtetuar faktet vendimtare të çështjes të cilat të kualifikuar në raport me normat materialo-juridike kanë përcaktuar që kërkesëpadia është e bazuar. Gjykata përveç se ka vërtetuar të gjitha faktet e çështjes të njëjtat edhe i ka arsyetuar dhe vlerësuar në mënyrë specifike, prandaj pretendimi të paditurës është i pa bazuar. Paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së, të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë dhe detyrohet AKP-ja të paguaj shpenzimet e përfaqësimit prej 208 euro.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi kishte parashtruar kërkesës tek Autoriteti i Likuidimit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri më Dhjetor 2005 në shumën 2,356.00 euro, por që AL kërkesën e kishte refuzuar si të pa vlefshme me arsyetimin se ishte parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Këtë konstatim të gabuar të Autoritetit të Likuidimit nuk e ka mbështetur Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me rastin e shqyrtimit të ankesës të paraqitur nga paditësi kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ035-0180/29 të datës 30 shtator 2013.

Shkalla e I-rë me Aktgjykimin C-IV-14-7222 ka konstatuar se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, me datë 27 mars 2007, me njoftimin e dërguar nga ish AKM-ja, dhe se ky njoftim e kishte ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se paditësi ishte punëtor i NSH "Komuna" në Prizren, sepse nga Libreza e punës e dorëzuar si provë vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune me NSH "Komuna". Shkalla e I-rë konstaton se paditësit nuk i është parashkruar plotësisht kërkesa tij kreditore dhe se të njëjtit i njihet pjesërisht e drejta për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën mars 2004 deri dhjetor 2005, në shumën prej 2,076,36 euro, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore prej 125,00 euro, të cilat duhet të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Gjersa për pagat periudhën janar dhe shkurt 2004 ishin refuzuar për shkak të parashkrimit.

Kolegji i Apelit i mbështet këto konstatime dhe gjetje faktike të Shkallës së I-rë, ndërsa e konsideron si të gabuar konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa e paditësit për paga është e parashkruar si tersi.

Kolegji i Apelit konstaton se është i drejtë konstatimi i Shkallës së I-rë se Njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës i datë 27 mars 2007 e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit dhe ky qëndrim ligjor tashmë është shprehur në shumë raste të mbyllura në jurisprudencën e deri tanishme të Kolegjit të Apelit. Në këtë njoftim thuhej "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësin e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura".

Paditësi duke u bazuar në këtë njoftim ka pritur të filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së, dhe pastaj të paraqesë kërkesën për paga. Paditësi në afatin ligjor ka paraqitur kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit, andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar për periudhën mars 2004 deri dhjetor 2005.

Paditësi, bazën e kërkesës e mbështet në provat siç janë: Kopja e librezës së punës; njoftimin për likuidimin e ndërmarrjes; kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit me numër PRZ035-0180/29, të datës 30.09.2013; letër pezullimin nga marrëdhënia e punës, të datës 27 mars 2007 si dhe listën e pagesave vjetore për vitin 2004 dhe 2005.

Andaj, edhe Kolegji i Apelit i konsideron si prova relevante provat e lartcekura me të cilat dëshmohet se paditësi ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se e paditura i ka mbetur borgj pagat e papaguara.

E paditura përveç thirrjes në parashkrim nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listë pagesën vjetore të pagave lëshuar nga personi përgjegjës i NSH.

Andaj duke u bazuar në këto arsye, refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja e ka paguara taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 21 shkurt 2023 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 15 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
